

Syllabusi i lëndës

Lënda: Tefsir I – Studime të Kuranit

Programi i studimit: Teologji Islame

Numri i ECTS kredive: 7 ECTS

Niveli dhe lloji i lëndës: Obligative

Kodi i lëndës: 107

Fondi i orëve: 3+2

VITI AKADEMIK : 2026/ 2027

Semestri: -II-

Mësimdhënësi: Prof. Ass. Dr. Valmire Batatina Krasniqi

Email: valmire.batatina@fsi-edu.net

Përmbajtja e shkurtër e lëndës:

Lënda “Hyrje në shkencat e Kur`anit” nënkupton një disiplinë të rëndësishme në studimet islame që merret me studimin e Kur`anit nga aspekte të ndryshme që nga zanafilla e tij e parë si: shpallja, mënyra e receptimit të Kur`anit nga ana e Pejgamberit Muhammed .a.s, memorizimi i tij nga ana e besimtarëve, shkrimi dhe evidentimi i tij përmes mjeteve të kohës, deri në momentin e tubimit dhe materializimit të Kur`anit brenda dy kopertinave në një koleksion zyrtar. Përveç aspektit historik dhe kontekstual mbi librin e shenjtë, kjo lëndë përmban edhe hulumtimin mbi përmbajtjen e tij, ndarjen dhe radhitjen kronologjike, opinionet e studiuesve të Lindjes dhe të Perëndimit për çështje dhe problematika të ndryshme krahasuese mbi Kur`anin etj., që nga ato klasike deri tek koha e sotme bashkëkohore.

Qëllimi i lëndës:

- Që studentët të pajisen me njohuri të rëndësishme mbi Kur`anin duke filluar nga struktura përbërëse e tij si; domethënia e fjalës Kur`ani në aspektin etimologjik dhe terminologjik, emrat e Kur`anit, forma dhe mënyra e shpalljes deri tek përmyllja e shpalljes dhe kodifikimi i tij në një koleksion.
- Të pasurohen me njohuri argumentuese dhe shkencore që ndihmojnë në kuptimin e saktë të tekstit të Kuranit, duke siguruar që studentët të kuptojnë ajetet në kontekstin e tyre të duhur dhe sipas parimeve të sakta të ekzegjezës.
- Të kuptojnë faktin se burimi i Kuranit është hyjnor dhe do të marrin informacionin bazë i nevojshëm për të kuptuar këtë libër të shenjtë.

-Të pasurohen me njohuri mbi prirjet e ndryshme që janë shfaqur në të kuptuarit e Kuranit dhe mund të ndihmojnë në promovimin e dialogut ndërfetar duke sqaruar keqkuptimet dhe duke ndihmuar në krijimin e një atmosfere respekti dhe mirëkuptimi reciprok.

- Të kenë edhe mundësinë që përmes debatit të nxisin diskutime rreth çështjeve të cilat ndërlidhin hyjnësinë e librave qiellore dhe dallimet mes tyre, të bëjnë krahasime analitike dhe kritike, të cilat janë të dobishme jo vetëm në studimet fetare, por edhe në aspekte të tjera të studimore.

Rezultatet e pritura të nxënies:

Pas përfundimit të këtij kursi studentët do të jenë në gjendje:

-Të kuptojnë saktë dhe drejtë zanafillën e Kur`anit – fillimin e shpalljes së tij deri te etapa e kodifikimit të tij në një koleksion, dhe të shmangen nga keqinterpretimet dhe deformimet në lidhje me tekstin kuranor.

-Të diskutojnë lidhjen mbi dhe rreth ndarjes së Kur`anit në ajete, fjali dhe kaptina dhe në ndarje të tjera të cilat i kanë definuar studiuesit e Kuranit.

-Të mbrojnë shenjtërinë e Kuranit dhe të librave të tjerë hyjnorë me argumente shkencore dhe analitike.

-Të zhvillojnë dhe prezantojnë mendim kritik në lidhje me tematika të cilat ndërlidhen me Kuranin dhe të shqyrtojnë metoda të avancuara të hulumtimit, që mund të aplikohen jo vetëm në studimet fetare, por edhe në fusha të tjera akademike.

-Të sigurojnë materiale edukative cilësore në lidhje me shkencat kuranore dhe të zhvillojnë një identitet të fortë fetar dhe kulturor.

-Të përshkruajnë vlerat e larta morale dhe shpirtërore të sjella nga Kurani në botën bashkëkohore.

Metodologjia e mësimdhënies:

Metodologjia e mësimdhënies së shkencave kuranore është e strukturuar për të siguruar një kuptim të thellë dhe të saktë të Kuranit. Kjo metodologji përfshin një kombinim të qasjeve tradicionale dhe moderne për të adresuar nevojat e studentëve dhe për të mbuluar në mënyrë efektive të gjitha aspektet e shkencave kuranore. Mund të përfshihen disa elemente kryesore si: qasja historike dhe kontekstuale e Kuranit e cila mund të realizohet përmes një debati mbi analizen e procesit historik të mbledhjes dhe ruajtjes së Kuranit gjatë kohës së Muhamedit a.s. dhe kalifëve të hershëm.

Po ashtu mësimi do të zhvillohet në formë të ligjëratave, nxitjes së studentëve për diskutime interaktive, përmes punimeve seminarike dhe hulumtimit të literaturës së re e cila lidhet ngusht me natyrën e lëndës. Do të bëhen edhe teste vlerësuese të kohëpaskohshme, sjellje të shembujve të ndryshëm mbi shkencat kuranore dhe punë grupore me studentë për tema të caktuara.

Përmbajtja e lëndës:

Java e pare: *NJOFTIM ME PLAN PROGRAMIN E LËNDËS- SYLLABUSIN*, metodologjinë dhe formën e zhvillimit të ligjëratave dhe vlerësimit të studentëve. Zanafilla e studimeve kuranore, definimi etimologjik dhe terminologjik i studimeve mbi Kuranin, studiuesit dhe librat e hershëm klasik të studimeve mbi Kur`anin dhe të atyre bashkëkohor. Studiuesit më të njohur shqiptar për Kuranin dhe veprat e tyre të njohura deri më tani.

Literatura: Prof.Dr. Enes Kariç “Hyrje në shkencat e Tefsirit”, f. 19-47, Dr. Shaban Muhammed Ismail “el-Medhal li Diraseti’l-Kuran ve’s-Sunne ve’l-Ulumi’l-Islamiije”, fq. 79-83, Prof. Dr. Muhsin Demirci “Tefsir Usûlü, fq. 20-40 si dhe materiale nga punimet shkencore.”

Java e dyte: *DEFINICIONET E KUR`ANIT*: linguistike, terminologjike, kuptimi i revelatës-vahjit, emrat e Kur`anit dhe veçoritë larta të Kuranit, Shkaqet dhe urtësitë e faktit që Kurani nuk u zbrit menjëherë.

Literatura: Ahmed fon Denfer, Historia e Kur`anit, fq. 20- 30, Abduladhim Ibrahim Muhammed el-Metani “Hasaisu’t-Tabiri’l-Kurani ve Simatuhu’l-Belagijje” fq. 108-120.

Java e tretë: *RENDITJA E TEKSTIT KURANOR*: suret si kaptina dhe emrat e tyre, përkufizimi i fjalës ajet, besmelja si invokacion në Kur`an, pastaj të ashtuquajturat “shkronja misterioze” ose “fillimet e sureve”.

Literatura: Hyrje në shkencat e Tefsirit, Enes Kariç, f.75-119, Ahmed Ibrahim b. Zubejr es-Sekafi “el-Burhan fi tenasubi’s-Suveri’l-Kuran”, fq. 40-50.

Java e katërt: *NGULITJA FJALËSORE DHE SHKRIMORE E KURANIT*: Tubimi i Kur`anit, shkrimi dhe memorizimi i tij në kohën e Muhmmedit a.s. Zanafilla e Kur`anit gjatë kohës së Kalifit Ebu Bekër. Kodifikimi në kohën e Kalifit Othman ibn Affanit dhe shumëzimi i Mus-hafit-kopjes origjinale të Kur`anit. Kopjet personale të Mus-hafit tek sahabinjët e caktuar. Dorëshkrimet e Kuranit të vjetra –ultra teksti i tyre .

Literatura: Dr. Qazim Qazimi, Njohuri mbi Kur`anin, fq. 93-114; Hyrje në shkencat e Tefsirit , Enes Kariç, fq. 121-139.

Java e peste: *LEXIMI I KURANIT*: Kuptimet e shtatë harfeve të Kuranit. Mendimet e dijetarëve rreth shtatë harfeve të Kuranit. Kiraetet (Leximet) e Kuranit.Zanafilla dhe zhvillimi historik i kiraeteve.

Literatura: Dr. Qazim Qazimi, Njohuri mbi Kur`anin, fq. 169-202; Hyrje në shkencat e Tefsirit , Enes Kariç, f. 137-154. Muhjiddin Dib Mestu “el-Vadihu fi Ulumi’l-Kuran, fq. 115-119, Prof. Dr. Muhsin Demirci “Tefsir Usulü” fq. 107-125.

Java e gjashtë: *NDARJA E KURANIT NË DY ETAPA KRYESORE KOHORE*: mekas dhe medinas, kriterët e ndarjes së Kuranit në mekas dhe medinas, karakteristikat e njohjes së ajeteve mekase dhe medinase, dobia shkencore e njohjes së kësaj ndarjeje për studiuesit dhe komentuesit e Kur`anit.

Literatura: Ahmed von Denfer, Historia e Kur`anit, f. 97-103, Musaid b. Sulejman et-Tajjar “el-Muharrer fi Ulumi’l-Kuran”, fq. 100-122.

Java e shtatë: *GJUHA E KURANIT*: stili, ekzistojnë apo nuk ekzistojnë fjalë të huaja në Kur`an, karakteristikat e stilit kur`anor. Teoritë islame dhe orientaliste mbi gjuhën e Kuranit.

Literatura: Hyrje në shkencat e Tefsirit , Enes Kariç, f.171-178.

Java e tetë: *ÇËSHTJA E ABROGIMIT- PEZULLIMIT TË AJETEVE NË KUR`AN*: polemika mes dijetarëve islame rreth çështjes së abrogimit, format e abrogimit, rëndësia e njohjes së e tematikës mbi abrogimin në Kur`an.

Literatura: Dr. Qazim Qazimi, Njohuri mbi Kur`anin, fq. 258-266; Xhabir Hamiti, ” Studime kur`anore” fq. 87-100, Ebu Bekr Ibnu`l-Arabi “en-Nasih ve`l-Mensuh fi`l-Kurani`l-Kerim V. I, Prof. Dr. Muhsin Demirci “Tefsir Usûlü , fq.232-249.

Java e nëntë: *LEXIMI I KAPTINËS FATIHA*: tefsiri Safvetu't-Tefâsîr, Lexim I kaptinës Fil nga tefsiri Safvetu't-Tefâsîr.

Literatura: Muhammed Ali es-Sabuni, Safvetu't-Tefâsîr, V. I.

Java e dhjetë: *SHKAQET E ZBRITJES SË AJETEVE NË KUR`AN*: rëndësia e njohjes së shkaqeve të shpalljes, kriteret e njohjes së shkaqeve të zbritjes në Kur`an, raporti i tekstit dhe shkakut të shpalljes.

Literatura: Sujuti “Lubabu`n-Nukul fi Esbabi`-Nuzul”, V.I., Hyrje në shkencat e Tefsirit , Enes Kariç, f.183-193.

Java e njëmbëdhjetë: *NDARJA TEFSIRORE E AJETEVE*: Ajetet e drejtpërdrejta (Muhkem) dhe të Figurshme (Muteshabih), Kuptimi i përgjithshëm i termave muhkem dhe muteshabih. Pikpamjet mbi ajetet e drejtpërdrejta dhe të atyre të figurshme. Çështja e mushkilit- ajeteve të cilat në shikim të parë duken kundërtë në Kuran. Kuptimi i përgjithshëm i termit mushkil. Ilustrime nga Kurani në lidhje me temën.

Literatura: Ibn Kutejbe “Tevilu Mushkilu`l-Kuran” fq. 30-70, 100-110, Abdurrahman Çetin “Kuran İlimleri ve Kuran-ı Kerim Tarihi” fq. 211-220, Dr. Valmire Batatina Krasniqi “Mushkilu`l-Kuran” fq. 30-40.

Java e dymbëdhjetë: *FORMA DHE STRUKTURA E KURANIT*: Renditja e ajeteve dhe kaptinave në Kur`an, forma e renditjes, kush e ka renditur Kur`anin në formën të cilën ai e ka sot, a ka pas ndërhyrje nga dora e njeriut në renditjen e Kur`anit!.

Literatura: Menaau`l- Kattan, “Mebahith fi ulumil Kur`an”, f.135-146

Java e trembëdhjetë: *PËRKTHIMET E KUR`ANIT*: lejohet apo nuk lejohet të përkthehet Kur`ani, përkthimet e Kur`anit në gjuhën shqipe.

Literatura: Dr. Qazim Qazimi, Njohuri mbi Kur`anin, fq. 303-317; Muhammed Ali es-Sabuni, Safvetu't-Tefâsîr V. II.

Java e katrëmbdhjetë: *PËRGJIGJJE NË TEZAT*: Pse Muhammedi a.s. nuk ishte autor i Kur`anit, por vetëm ndërmjetësues? Kush e etikoi Muhammedin si autor të Kur`anit? Cfar thotë Kur`ani në lidhje me këtë? Sa janë të vjetra shpifjet rreth kësaj çështjeje?

Literatura: Prof.dr. Fadel Hasen Abbas, “Itkanul-burhan fi ulumil-Kur’an”, f. 89.120

Kriteriumi dhe komponentet e vlerësimit:

Pjesëmarrje dhe angazhimi në ligjeratë 10%

Punimi seminarik 15%

Testi intermedier 25%

Provimi final 50%

Total 100%

Literatura e obligueshme :

1. Dr. Qazim Qazimi, “Njohuri mbi Kur’anin”, Prishtinë, 2006.
2. Ahmed Von Denffer, “Historia e Kur’anit”, Tiranë, 2006.
2. Prof. Enes Kariç, “Hyrje në shkencat e Tefsirit”, Prishtinë, 1996
3. Sujuti, “el-Itkan fi ulumi`l-Kur’an”, Bejrut.
4. Muhammed Ali es-Sabuni, Safvetu't-Tefâsîr. Daru`l-Kur’ani`l-Kerim, Bejrut.

Literatura opsionale:

- 1 .Andrew Rupin&Frithojf Schoun, “ Kurani dhe komentimi i tekstit Kuranor”, Drita, Gjilan 2008.
2. Shaban Muhammed Ismail “el-Medhal li Diraseti`l-Kuran ve`s-Sunne ve`l-Ulumi`l-Islamijje”, Daru`l-Ensar.
3. Malik Ibn Nebi, “ Fenomeni kuranor” Prishtinë, 1998.
4. Bediuzzeman Seid Nursi, “ Mrekullia e Kur’anit” Gostivar, 2003.
5. Ingrid Mattson, “ The story of the Qur`an”, Malden – USA, 2008.
6. Abduladhim Ibrahim Muhammed el-Metani “Hasaisu`t-Tabiri`l-Kurani ve Simatuhu`l-Belagijje”, Mektebetu`l-Islamijje, Egjipt 1992.
7. Muhjiddin Dib Mestu “el-Vadihu fi Ulumi`l-Kuran”, Daru`l-Kelam, Siri 1998.
8. Sujuti “Lubabu`n-Nukul fi Esbabi`-Nuzul”, Merkezu`d-Dirasati`l-Kuraniyje, Rijad.

9. Zerkeshi “El-Burhan Fi Ulumi’l-Kur’an”, Daru’t-Turath, Egjipt.

Edward Sell, “The historical Development Of The Qu’ran”, 1905.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studenti është i obliguar për vijimin e rregullt të ligjëratave dhe ushtrimeve (mbahet evidenca për studentët e rregullt). Të gjithë studentët janë të obliguar t’i përfillin rregullat e mirësjelljes: mbajtja e qetësisë gjatë mësimit si dhe respektimi i kohës së ligjeratës. Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike duhet të fikën (apo të lihen në vibrim/pa zë) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimit.

Shënim: Nëse vijshmëria e një studenti në ligjeratë vlersohet nën 70%, atëher ai/ajo do ta humb të drejtën që t’i nënshtrohet kolokviumit dhe provimit final.

Konsultimet:

Orët e konsultimeve mbahen në kabinet sipas orarit të dhënë dhe mund të shfrytëzohet për ndihmë për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me lëndën.